



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.17, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË SHËRBIMI DHE BANIMI 11, 12, 13, 14, 15, 16 KATE MBI TOKË ME 4 KATE PARKIMI NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË RRUGËN "FORTUZI", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligj Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë "TDT & Partners" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë shërbimi dhe banimi 11, 12, 13, 14, 15, 16 kate mbi tokë me 4 kate parkimi nëntokë", me vendndodhje në Rrugën "Fortuzi", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "TDT & Partners" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/12/2024